

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini-Simnica procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit F.G., nga Gj., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga i dënuari kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr. 448/2016 datë 09.01.2018, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1nr.516/2018 datë 11.07.2018, në seancën e kolegjit e mbajtur më 01.10.2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit F.G. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, P.nr.448/2016 datë 09.01.2018, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.516/2018 datë 11.07.2018.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjakovë me aktgjykimin P.nr.448/2016 datë 09.01.2018, të dënuarin F.G. e ka shpallur fajtor për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par 1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumen prej 500 (pesë qind) €, të cilin dënim i dënuari do ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen veprë të re penale. Nëse i dënuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë gjobën gjykata në bazë të nenit 46 par 3 të KPRK, dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim burgu duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20 € të gjobës. Është obliguar i dënuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €. E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.516/2018 të datës 11.07.2018, e ka refuzuar ankesën e të dënuarit, kurse aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari F.G., për shkak të shkeljeve të ligjit penal nga neni 431 pika 1.1 të KPPK, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432 pika 1.3 të KPPK, shkeljeve të drejtave të siguruara me KPPK dhe me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar kurse aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të bihet aktgjykim lirues për të dënuarin.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.158/2018 të datës 18.09.2018, ka paraqitur përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë i dënuari pretendon se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në aktgjykimin e kundërshtuar nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe ato që janë paraqitur janë kundërthënëse dhe për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave dhe vet këtyre procesverbaleve që paraqet shkelje të dispozitave të procedurës penale. Më pastaj në kërkesë pretendohet se bazë për ngritjen e aktakuzës ka qenë kallëzimi penal i kinse palës së dëmtuar e cila ka interes material që të sajoi provat dhe kallëzimin penal sipas interesit dhe vullnetit të sajë. Në këtë drejtim KEDS dhe punëtorët e KEDS-it janë më të favorizuar se konsumatori. Thuhet se dëshmitarët-punëtorët e KEDS-it kanë konstatuar keqpërdorimin, por ky keqpërdorim nuk është vërtetuar nga ndonjë institucion shtetërorë, nuk është bërë ekspertiza apo bazhdarimi i orës dhe besimi i falet vetëm punëtorëve të KEDS-it të cilët kanë mundur ta ndërmarrin vet veprimin mekanik me thyerjen e xhamit dhe varjen e shiritit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Kështu në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij, po ashtu i njëjti në përshkrimin faktik të veprës penale përmban të gjitha elementet objektive dhe subjektive të cilat përbëjnë figurën e veprës penale. Në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar janë përshkruar në mënyrë të qartë veprimet inkriminuese të të dënuarit që përbëjnë veprën

penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtorë, pra mënyra se si i dënuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitiv të aktgjyqimit të kundërshtuar, veprime këto që përmbajnë elementet qenësore të veprës në fjalë. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë si në dispozitiv po ashtu edhe në arsyetimin e aktgjyqimit ka përshkruar veprimet e të dënuarit e lidhur me këto veprime të të dënuarit ka dhënë arsye bindëse duke i mbështetur edhe në prova konkrete, për çka kjo gjykatë vlerëson se pretendimi mbi këtë bazë është i pabazuar.

Pjesa tjetër e kërkesës, i referohet shkeljes së ligjit penal mirëpo lidhur me këtë pretendim i dënuari nuk ka specifikuar se cila dispozitë e ligjit penal është shkelur, kurse nga referati i kërkesës rezulton se ky pretendim ndërlidhet me gjendjen faktike. Kështu potencohet se gjykata nuk i ka marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës në veçanti thuhet se dëshmitarët-punëtorët e KEDS-it kanë konstatuar keqpërdorimin, por ky keqpërdorim a është vërtetuar nga ndonjë institucion shtetërorë, a është bërë ekspertiza apo bazhdarimi i orës apo besimi i falet vetëm punëtorëve të KEDS-it të cilët kanë mundur ta ndërmarrin vet veprimin mekanik me thyerjen e xhamit dhe varjen e shiritit, ka të bëjnë me gjendjen e fakteve për çfarë në kuptim me dispozitën e nenit 432 par 2 të KPPK, ky mjet i jashtëzakonshëm juridik nuk mund të ushtrohet.

Nga arsyet e dhëna më sipër, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 par.1 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të aktgjyqimit.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr.231/2018, më 01.10.2018

Procesmbajtëse,  
Mirlinda Mejzini-Simmica

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Mustafa